



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 dhjetor 2015
Nr. ref.:RK871/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI177/14

Parashtrues

Miodrag Janković

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
U.ZH-A.A. nr. 6/2014, të 21 korrikut 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Janković Miodrag nga Komorani, me vendbanim të përhershëm në Beograd, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, U.ZH.-A.A. nr. 6/2014, të 21korrikut 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartpërmendur. Parashtruesi gjithashtu konteston edhe vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (në tekstin e mëtejme: PZAP), A. nr. 7251/2014, të 2 qershorit 2014, dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ), nr. 20140806004875, me të cilat pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) nga neni 24 [Barazia para Ligjit], nga neni 32 [E drejta për Mjete Juridike], nga neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nga neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe nga neni 3, i Protokollit 1 [E drejta për zgjedhje të lira], nga neni 13 [E drejta për zgjedhje efektive] dhe nga neni 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI177/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin KSH. KI177/14, në vend të gjyqtarit Enver Hasani, mandati i të cilit kishte përfunduar, emëroi anëtare të Kolegjit gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 21 janar 2015, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dokumentacionin plotësues nga ai, si: autorizimin për personat e caktuar në kërkesë për dorëzim të korrespondencës zyrtare në emër të tij dhe vendimin e KQZ-së, me të cilin iu refuzua kërkesa për përfshirje në listën e votuesve.
9. Më 11 shkurt 2015, Gjykata pranoi nga parashtruesi autorizimin e kërkuar por jo edhe vendimin e KQZ-së.

10. Më 2 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës ishte banor i Kosovës me vendbanim në Fushë-Kosovë, deri në qershor të vitit 1999, kur kishte shkuar të jetojë në Beograd, Republika e Serbisë.
12. Me qëllim të realizimit të së drejtës për pjesëmarrje në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të vitit 2004 në Kosovë si votues, parashtruesi kishte paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për t'u përfshirë në listën zgjedhore.
13. Në një datë të paspecifikuar, KQZ-ja ka nxjerrë Vendimin nr. 2014080600875, me të cilin ka refuzuar kërkesën e parashtruesit për përfshirje në listat zgjedhore, me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte plotësuar kushtet sipas nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.
14. Më 30 maj 2014, parashtruesi paraqiti ankesë në PZAP duke kontestuar vendimin e KQZ-së.
15. Më 2 qershor 2014, PZAP-i, me Vendimin e vet A. nr. 7251/2014, refuzoi ankesën e parashtruesit, duke vërtetuar vendimin e KQZ-së dhe duke dhënë po të njëjtin arsyetim se parashtruesi nuk i ka plotësuar kushtet për regjistrim në listat zgjedhore sipas nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.
16. Kundër vendimit të PZAP-it, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale.
17. Më 13 qershor 2014, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) i dërgoi parashtruesit një urdhërpagesë të plotësuar dhe të vulosur nga Gjykata Supreme e Kosovës, për pagesën e taksës gjyqësore në shumën prej 30 €.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës i kishte dërguar Gjykatës Supreme një kërkesë për lirim nga obligimi i pagesës së taksës, për shkak të gjendjes jo të mirë materiale.
19. Më 21 korrik 2014, Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktvendimin U.ZH.-A.A.nr. 6/2014 me të cilin ka hedhur poshtë ankesën e parashtruesit.
20. Në arsyetimin e Aktvendimit, Gjykata Supreme ka theksuar: *“Me nenin 2.4 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, ndër të tjera, është përcaktuar se nocioni “parashtresë” do të thotë padi, kundërpadi, ankesë. Me nenin 6.1 të Udhëzimit në fjalë, është përcaktuar se taksat duhet të paguhet me rastin e dorëzimit të parashtresës – ankesës, ndërsa me nenin 6.5 të Udhëzimit, është përcaktuar që nëse taksat nuk paguhet nga parashtruesi i ankesës deri në datën e caktuar, gjykata do të hedh poshtë parashtresën - ankesën për të cilën nuk janë paguar taksat”.*

21. Gjykata Supreme më tej kishte konstatuar se përkundër faktit që parashtruesi ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës, ai nuk e kishte përmbushur këtë obligim, andaj *“sipas mendimit të kësaj gjykate ankesa duhet të hidhet poshtë”*.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke mos shqyrtuar ankesën e tij në meritat e saj, i ka mohuar mbrojtjen gjyqësore të drejtave të tij të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës, si dhe e ka vënë në pozitë të pabarabartë para ligjit gjë që sipas tij, për pasojë, ka rezultuar me mohimin e të drejtës së tij për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare, duke i cenuar kështu të drejtën kushtetuese të paraparë me nenin 45 të Kushtetutës dhe me nenin 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.
23. Parashtruesi më tej ankohet se mjete juridik i ankesës në rastin e tij nuk ka qenë efektiv, sepse nuk i ka mundur ta realizojë të drejtën e tij, andaj ai pretendon se ka shkelje të nenit 32 të Kushtetutës lidhur me nenin 13 të KEDNJ-së që garanton të drejtën për zgjedhje efektive.
24. Parashtruesi ka kërkuar që Gjykata t'i akordojë kompensim për dëmin material në shumën prej 30.00 € në emër të taksës gjyqësore.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
27. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- [...]*
- (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*
28. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të vlerësojë çështjen nëse Aktvendimi i Gjykatës Supreme, i 21 korrikut 2014, dhe vendimet e KQZ-së dhe PZAP-it i kanë pamundësuar atij pjesëmarrjen në zgjedhjet parlamentare në Kosovë në vitin 2014, dhe kjo ka rezultuar me

shkeljet kushtetuese dhe të KEDNJ-së të theksuara si në pikën tre të këtij raporti.

29. Gjykata më tej thekson se, përkundër kërkesës me shkrim, parashtruesi nuk i kishte dërguar vendimin e KQZ-së me të cilin atij iu refuzua aplikacioni për përfshirje në listën e votuesve, andaj Gjykata nuk mund të vlerësojë nëse ky vendim ka shkaktuar shkelje të Kushtetutës në dëm të parashtruesit.
30. Sipas rregullit 29, pika 4, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, është detyrë e parashtruesit të bashkëngjitë dokumentacionin e nevojshëm me kërkesën e tij, që dëshmon për shkeljet e pretenduara. Nuk është detyrë e Gjykatës që të ndërtojë rastin në vend të tij apo të kërkojë dokumentacion sipas detyrës zyrtare, që eventualisht do të shkonte në favor të tij.
31. Gjykata vë në dukje se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DL-027-2008, të 15 qershorit 2008, ka paraparë se secili person, për të ushtruar të drejtën kushtetuese për pjesëmarrje në zgjedhje, duhet t'i përmbushë kushtet si në vijim:

Neni 5 - E drejta për të votuar

- 5.1 Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse ika mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet, dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese:
 - a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;
 - b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës; apo
 - c) ka fituar statusin e refugjatit, siç është përkufizuar në Konventën Lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e saj të 16 dhjetorit 1966, në apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t'u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës;
32. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se PZAP-i, më 2 qershor 2014, ka nxjerrë Vendimin A. nr. 7251/2014, me të cilin ka refuzuar ankesën e parashtruesit kundër Vendimit të KQZ-së duke theksuar se "*parashtruesi nuk i ka plotësuar kushtet për regjistrim në listat zgjedhore sipas nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme*" dhe nuk kishte gjetur se vendimi i KQZ-së përmban shkelje ligjore sikur pretendon parashtruesi i kërkesës.
33. Gjykata më tej konstaton se bazuar në kompetencat e PZAP-it, të cilat parashihen me Ligjin Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 87, më 16 nëntor 2010, i cili në nenin 1 ka paraparë "*PZAP do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtrësia dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor*".

34. Për më tepër, siç u tha më lart, është e qartë se KQZ-ja dhe PZAP-i janë organe të përcaktuara me ligj për të vendosur nëse parashtruesi i ka plotësuar apo jo kushtet e parapara me ligj për t'u përfshirë në listën e votuesve dhe nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese t'i verifikojë këto fakte sepse ato janë të sferës ligjore dhe jokushtetuese.
35. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo në rastin konkret nga organet e pavarura. Është roli i gjykatave të rregullta ose i organeve administrative të përcaktuara me ligj, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
36. Në rrethanat e rastit, Gjykata konstaton se parashtruesit iu pranua aplikacioni për pjesëmarrje në zgjedhje: Me vendim të KQZ-së u konstatua se ai nuk i plotësonte kushtet ligjore për t'u përfshirë në listën e votuesve dhe iu mundësua procesi ankimor dhe ankesa e tij u refuzua, andaj duke marrë parasysh procedurat e zhvilluara Gjykata nuk mund të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 45 të Kushtetutës [E Drejta për Zgjedhje dhe Pjesëmarrje] dhe të nenit 3 të Protokollit 1 të KEDNJ-së [E Drejta për Zgjedhje të Lira], për faktin e vetëm se rezultati i aplikimit të parashtruesit ka qenë i pafavorshëm për të.
37. Për më tepër, Gjykata thekson se e "drejta për zgjedhje dhe pjesëmarrje", e paraparë me Kushtetutë, apo "e drejta për zgjedhje të lira" e paraparë me Protokollin 1 të KEDNJ-së nuk është një e drejtë absolute dhe e pa limituar por ajo mund të jetë objekt i kufizimeve ligjore në secilin shtet veç e veç.
38. Në rastin *Shindler kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) kishte konstatuar se nuk ka shkelje të nenit 3, të Protokollit 1 të KEDNJ-së me rastin e refuzimit të së drejtës për pjesëmarrje në zgjedhjet e përgjithshme në Britani, të mbajtura më 5 maj 2010, për personin që nuk ka jetuar në Britani për një kohë më të gjatë se koha e përcaktuar me ligjin në fuqi, dhe se kjo e drejtë do t'i nënshtrohet kufizimeve të parapara me ligjin britanik në atë kohë (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Shindler v. the United Kingdom* të 7 majit 2013 – aplikacioni nr. 19840/09).
39. Sa i përket çështjes së hedhjes poshtë të ankesës së parashtruesit nga Gjykata Supreme, shkak i mospagesës së taksës gjyqësore, Gjykata konstaton se Aktvendimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë në mbështetje të një akti juridik (Udhëzimi Administrativ nr. 2008/02 të KGJK) që rregullon këtë materie andaj, si i tillë nuk është një akt arbitrar dhe i pabazuar.
40. Për më tepër, në arsyetimin e aktvendimit të vet Gjykata Supreme kishte cituar nenin 6.5 të Udhëzimit, ku qartë është përcaktuar "që nëse taksat nuk paguhen nga parashtruesi i ankesës deri në datën e caktuar, gjykata do të hedh poshtë parashtruesin - ankesën për të cilën nuk janë paguar taksat".

41. Parashtruesi nuk mundi të mbështesë pretendimet e tij me ndonjë provë që do të tregonte se persona të caktuar janë liruar nga obligimi i pagesës së taksës gjyqësore apo që ky obligim vlen vetëm për grupe të caktuara të popullatës, sikur ka pretenduar në ankesë. Është tërësisht e qartë se parashtruesi nuk paraqiti prova që do të dëshmonin se ky aktvendim është tregues i shkeljeve të pretenduara për pabarazi para ligjit, apo edhe akt juridik diskriminues.
42. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI121/13, të parashtrueses L. M., kishte konstatuar se aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 8 majit 2013, dhe të Gjykatës së Apelit të 12 korrikut 2013 me të cilat u refuzuan ankesat e parashtrueses për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore nuk ishin të papajtueshme me Kushtetutën dhe kjo Gjykatën e shpie deri te përfundimi se taksat gjyqësore janë obligim për të gjithë parashtruesit, pa marrë parasysh përkatësinë e grupit të popullatës dhe se para ligjit për çështjen e njëjtë palët janë trajtuar njëjtë.
43. Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të gjejë shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe të nenit 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe të neneve 14 [Ndalimi i diskriminimit] dhe 13 [E drejta për zgjedhje efektive] të KEDNJ-së.
44. Gjykata në përgjigje të kërkesës së parashtruesit për akordimin e dëmit material të pësuar thekson se bazuar në Kushtetutë dhe në Ligjin për Gjykatën ajo nuk ka kompetencë të akordimit të një dëmi të tillë.
45. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij.
46. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, si e tillë, e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi